

VENDIM
Nr.1236, datë 16.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i dytë i pikës 4 të vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Pagesa e aftësisë së kufizuar, në masën e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, bëhet nga shërbimet bankare, që funksionojnë pranë njësisë së qeverisjes vendore, ku ka vendbanimin përfituesi, ose nga shërbimi postar për njësitë e qeverisjes vendore, ku nuk ka një të tillë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha